

PËRFITIMET QË TRAJTON INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në mbështetje të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM-ve, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Udhëzimeve të ISSH-së, që kanë dalë në zbatim të Ligjit të sigurimeve shoqërore, llogarit dhe jep perfitime, të cilat do t’i sqarojmë në këtë manual.

Të ardhurat që përfitohen nga Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, janë si më poshtë:

- I.** Përfitimet nga Pensionet.
- II.** Përfitimet nga Dega e sigurimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.
- III.** Përfitimet nga Dega e sigurimit të barrë lindjeve.
- IV.** Përfitimet nga Dega e sigurimit të sëmundjeve.



I. KREU I PARË

PËRFITIMET NGA DEGA E SIGURIMIT TË PENSIONEVE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në zbatim të neneve 30 - 42, të kreut të III-të, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, personave të siguruar iu paguan përfitime, si më poshtë vijon:

1. Pension pleqërie;
2. Pension të reduktuar pleqërie;
3. Pension si nënë me shumë fëmijë;
4. Pension invaliditeti;
5. Pension të reduktuar invaliditeti;
6. Pension të pjesshëm invaliditeti;
7. Pension familjar;
8. Pagesë për vdekje.

I.1 Pensioni i pleqërisë

1. Baza ligjore:

- a) Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- b) Rregullore nr.1 datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar.

2. Kushtet e përfitimit:

- a) Personat që kanë moshën dhe periudhat e sigurimit, kanë të drejtën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, sipas tabelave të mëposhtme:

a) PËR BURRAT						
Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	50	20	55	25	60	25
1994	50	20	55	25	60	25
1995	51	21	56	26	60	26
1996	51	21	56	27	60	27
1997	52	22	57	28	60	28
1998	52	22	57	29	60	29
1999	53	23	58	30	60	30
2000	53	23	58	31	60	31
2001	54	24	59	32	60	32
01.07.2002 - 30.06.2003	54	24	59	33	60v 6m	33
01.07.2003 - 30.06.2004	55	25	60	34	61v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	55	25	60v 6m	35	61v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	56	26	61v	35	62v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	56	27	61v 6m	35	62v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	57	28	62v	35	63v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	57	29	62v 6m	35	63v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	58	30	63v	35	64v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	58	31	63v 6m	35	64v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	59	32	64v	35	65v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	59	33	64v 6m	35	65v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	60	34	65v	35	65v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	60v 6m	35	65v	35v	65v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	61v	35v 4m	65v	35v 4m	65v	35v 4m
01.01.2016 - 31.12.2016	61v 6m	35v 8m	65v	35v 8m	65v	35v 8m

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

01.01.2017 - 31.12.2017	62v	36v	65v	36v	65v	36v
01.01.2018 - 31.12.2018	62v 6m	36v 4m	65v	36v 4m	65v	36v 4m
01.01.2019 - 31.12.2019	63v	36v 8m	65v	36v 8m	65v	36v 8m
01.01.2020 - 31.12.2020	63v 6m	37v	65v	37v	65v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	64v	37v 4m	65v	37v 4m	65v	37v 4m
01.01.2022 - 31.12.2022	64v 6m	37v 8m	65v	37v 8m	65v	37v 8m
01.01.2023 - 31.12.2023	65v	38v	65v	38v	65v	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	65v	38v 4m	65v	38v 4m	65v	38v 4m
01.01.2025 - 31.12.2025	65v	38v 8m	65v	38v 8m	65v	38v 8m
01.01.2026 - 31.12.2026	65v	39v	65v	39v	65v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	65v	39v 4m	65v	39v 4m	65v	39v 4m
01.01.2028 - 31.12.2028	65v	39v 8m	65v	39v 8m	65v	39v 8m
01.01.2029 - 31.12.2029	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2033- 31.12.2033	65v 1m	40v	65v 1m	40v	65v 1m	40v
01.01.2034- 31.12.2034	65v 2m	40v	65v 2m	40v	65v 2m	40v
01.01.2035- 31.12.2035	65v 3m	40v	65v 3m	40v	65v 3m	40v
01.01.2036- 31.12.2036	65v 4m	40v	65v 4m	40v	65v 4m	40v
01.01.2037- 31.12.2037	65v 5m	40v	65v 5m	40v	65v 5m	40v
01.01.2038- 31.12.2038	65v 6m	40v	65v 6m	40v	65v 6m	40v
01.01.2039-	65v 7m	40v	65v 7m	40v	65v 7m	40v

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

31.12.2039						
01.01.2040- 31.12.2040	65v 8m	40v	65v 8m	40v	65v 8m	40v
01.01.2041- 31.12.2041	65v 9m	40v	65v 9m	40v	65v 9m	40v
01.01.2042- 31.12.2042	65v10m	40v	65v10m	40v	65v10m	40v
01.01.2043- 31.12.2043	65v11m	40v	65v11m	40v	65v11m	40v
01.01.2044- 31.12.2044	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2045- 31.12.2045	66v1m	40v	66v1m	40v	66v1m	40v
01.01.2046- 31.12.2046	66v 2m	40v	66v 2m	40v	66v 2m	40v
01.01.2047- 31.12.2047	66v 3m	40v	66v 3m	40v	66v 3m	40v
01.01.2048- 31.12.2048	66v 4m	40v	66v 4m	40v	66v 4m	40v
01.01.2049- 31.12.2049	66v 5m	40v	66v 5m	40v	66v 5m	40v
01.01.2050- 31.12.2050	66v 6m	40v	66v 6m	40v	66v 6m	40v
01.01.2051- 31.12.2051	66v 7m	40v	66v 7m	40v	66v 7m	40v
01.01.2052- 31.12.2052	66v 8m	40v	66v 8m	40v	66v 8m	40v
01.01.2053- 31.12.2053	66v 9m	40v	66v 9m	40v	66v 9m	40v
01.01.2054- 31.12.2054	66v10m	40v	66v10m	40v	66v10m	40v
01.01.2055- 31.12.2055	66v11m	40v	66v11m	40v	66v11m	40v
01.01.2056- 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v

b) PËR GRATË

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	45	15	50	20	55	20
1994	45	15	50	21	55	21
1995	46	16	51	22	55	22
1996	46	17	51	23	55	23
1997	47	18	52	24	55	24
1998	47	19	52	25	55	25
1999	48	20	53	26	55	26
2000	48	21	53	28	55	28
2001	49	22	54	30	55	30
01.07.2002 30.06.2003	49	23	54	32	55v 6m	32
01.07.2003 - 30.06.2004	50	24	55	34	56v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	50	25	55v 6m	35	56v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	51	26	56v	35	57v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	51	27	56v 6m	35	57v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	52	28	57v	35	58v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	52	29	57v 6m	35	58v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	53	30	58v	35	59v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	53	31	58v 6m	35	59v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	54	32	59v	35	60v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	54	33	59v 6m	35	60v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	55	34	60v	35	60v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	55v 6m	35	60v	35	60v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	56v	35	60v 2m	35v4m	60v2m	35v4m
01.01.2016 - 31.12.2016	56v 6m	35	60v4m	35v8m	60v4m	35v8m
01.01.2017 -	57v	35	60v6m	36v	60v6m	36v

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

30.12.2017						
01.01.2018 - 30.06.2018	57v 6m	35	60v8m	36v4m	60v8m	36v4m
01.01.2019 - 31.12.2019	58v	35	60v10m	36v8m	60v10 m	36v8m
01.01.2020 - 31.12.2020	58v 6m	35	61v	37v	61v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	59v	35	61v2m	37v4m	61v2m	37v4m
01.01.2022 - 31.12.2022	59v 6m	35	61v4m	37v8m	61v4m	37v8m
01.01.2023 - 31.12.2023	60v	35	61v6m	38v	61v6m	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	60v4m	35v6m	61v8m	38v4m	61v8m	38v4m
01.01.2025 - 31.12.2025	60v8m	36v	61v10m	38v8m	61v10 m	38v8m
01.01.2026 - 31.12.2026	61v	36v6m	62v	39v	62v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	61v4m	37v	62v2m	39v4m	62v2m	39v4m
01.01.2028 - 31.12.2028	61v8m	37v6m	62v4m	39v8m	62v4m	39v8m
01.01.2029 - 31.12.2029	62v	38v	62v6m	40v	62v6m	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	62v4m	38v6m	62v8m	40 v	62v8m	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	62v8m	39v	62v10m	40v	62v10 m	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2033- 31.12.2033	63v 2m	40v	63v 2m	40v	63v 2m	40v
01.01.2034- 31.12.2034	63v 4m	40v	63v 4m	40v	63v 4m	40v
01.01.2035- 31.12.2035	63v 6m	40v	63v 6m	40v	63v 6m	40v
01.01.2036- 31.12.2036	63v 8m	40v	63v 8m	40v	63v 8m	40v
01.01.2037- 31.12.2037	63v10 m	40v	63v10m	40v	63v10 m	40v
01.01.2038- 31.12.2038	64v	40v	64v	40v	64v	40v
01.01.2039- 31.12.2039	64v2m	40v	64v2m	40v	64v2m	40v

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

01.01.2040-31.12.2040	64v4m	40v	64v4m	40v	64v4m	40v
01.01.2041-31.12.2041	64v6m	40v	64v6m	40v	64v6m	40v
01.01.2042-31.12.2042	64v8m	40v	64v8m	40v	64v8m	40v
01.01.2043-31.12.2043	64v10m	40v	64v10m	40v	64v10m	40v
01.01.2044-31.12.2044	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2045-31.12.2045	65v2m	40v	65v2m	40v	65v2m	40v
01.01.2046-31.12.2046	65v4m	40v	65v4m	40v	65v4m	40v
01.01.2047-31.12.2047	65v6m	40v	65v6m	40v	65v6m	40v
01.01.2048-31.12.2048	65v8m	40v	65v8m	40v	65v8m	40v
01.01.2049-31.12.2049	65v10m	40v	65v10m	40v	65v10m	40v
01.01.2050-31.12.2050	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2051-31.12.2051	66v2m	40v	66v2m	40v	66v2m	40v
01.01.2052-31.12.2052	66v4m	40v	66v4m	40v	66v4m	40v
01.01.2053-31.12.2053	66v6m	40v	66v6m	40v	66v6m	40v
01.01.2054-31.12.2054	66v8m	40v	66v8m	40v	66v8m	40v
01.01.2055-31.12.2055	66v10m	40v	66v10m	40v	66v10m	40v
01.01.2056-31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v

- b) Nënats që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë mbi 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet periudhë sigurimi.

3. Masa e pensionit të pleqërisë:

- Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit, që ka realizuar personi, me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas tabelave të daljes në pension pleqërie, bazuar në moshë dhe vite sigurimi, shumëzuar me pensionin social;
- Shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, gjatë gjithë periudhës kontributive;
- Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social.

I.2 PENSIONI I REDUKTUAR I PLEQËRISË

1. Baza ligjore:

- a) Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- b) Rregullore nr.1 datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar.

2. Kushtet e përfitimit:

- a) Personat që kanë periudha sigurimi kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension, sipas tabelës së mësipërme;
- b) Nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës, ose të vetëpunësuar.

3. Masa e pensionit të reduktuar të pleqërisë:

Masa e pensionit të reduktuar të pleqërisë është pjesë e pensionit të pleqërisë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i pleqërisë shumë të cilin del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit para mbushjes së moshës, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit është 0.6 % në muaj.

Shëmbull: Nëqoftëse një përfitues kërkon pension të reduktuar 20 muaj para mbushjes së moshës për pension të plotë pleqërie, nga pensioni i plotë mujor i llogaritur, që mund t’i caktohet 24.000 lekë, do t’i zbritet 12 % (që del nga prodhimi i 20 (muaj) që e ka përfituar më shpejt pensionin e pleqërisë me 06 %, që është koeficienti i miratuar).

I.3 PENSIONI I PLEQËRISË SI NËNË ME SHUMË FËMIJË

1. Baza ligjore:

- a) Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- b) Rregullore nr.1 datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar.

2. Kushtet e përfitimit:

- a)** Personat që kanë periudha sigurimi, kanë të drejtën e përfitimit të pensionit të plotë të pleqërisë kur:
 - b)** Plotësojnë moshën 55 vjeç;
 - c)** Kanë 30 vjet periudhë sigurimi;
 - d)** Janë tërhequr nga veprimtaria ekonomike;
 - e)** Kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë të rritur mbi 8 vjeç.

3. Masa e pensionit të pleqërisë si nënë me shumë fëmijë:

- Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit, që ka realizuar personi, me periudhën e sigurimit të kërkuar, 30 vite sigurimi, shumëzuar me pensionin social;
- Shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, gjatë gjithë historisë kontributive;
- Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social.

DOKUMENTACIONI PËR PENSION:

- Pleqërie;
- Pleqërie të reduktuar;
- Si nënë me shumë fëmijë.

Për të përfituar pension pleqërie, pension të reduktuar dhe pension si nënë me shumë fëmijë përfituesi ose i autorizuari me prokurë paraqitet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore (ALSSH) të vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfitimit të pensionit të pleqërisë.

Përfituesi për pension pleqërie ose i autorizuari me prokurë, së bashku me kërkesën duhet të paraqesë dhe dokumentat e mëposhtme:

a) Dokumentat që vërtetojnë moshën dhe identitetin:

- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Çertifikatë e gjëndjes familjare;
- Çertifikatë martese (vetëm për kërkueset femra);
- Kur kërkohet pension si nënë me shumë fëmijë dhe në çertifikatën familjare nuk figurojnë të gjithë fëmijët, duhet të paraqitet edhe çertifikatë e veçantë lindjeje, martese ose vdekjeje, për fëmijet që nuk figurojnë në çertifikatën e gjëndjes familjare;
- Vërtetim nga Komuna/Bashkia për ndryshimin e gjeneralitetit;
- Vërtetim nga qendra e fundit e punës për gjeneralitetin.
- Dy fotografi.

b) Dokumentat që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës janë:

- Libreza e punës;
- Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj;
- Vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore;
- Vendim gjykate për njohje të vjetërsisë në punë (nëse periudha e punës nuk provohet me dokumente zyrtare);

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

- Vërtetim i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj);
- Vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët;
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë për kërkueset femra (kur kanë mbaruar studimet e larta, me shkëputje nga puna).
- c) *Për personat që përfitojnë nga Ligji nr. 7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe reabilitimin e ish-të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë” duhen edhe:***
 - Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
 - Vërtetim për kohën e vuajtjes së dënimit, lëshuar nga Ministria e Rendit Publik;
 - Vërtetim për faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij, të lëshuar nga Komisioni i Ministrisë së Rendit Publik dhe Ministrisë së Drejtësisë;
 - Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton qënien në punë.
- d) *Dokumentat që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:***
 - Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip (nëse ka punuar dhe ka derdhur kontribute për periudhat pas datës 01.01.1994);
Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton pagën ose derdhjen e periudhave kontributive.

I.4 PENSIONI I INVALIDITETIT

Personi që bëhet i paaftë për çdo veprimtari ekonomike dhe ka gjymtime të forta e dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin), ka të drejtë të marrë pension invaliditeti.

1. Baza ligjore:

- a)** Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b)** Rregullore nr.1 datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar.
- c)** Rregullore e përbashkët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, datë 30.05.2003 “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e KMCAPI-t të invalidëve”.

2. Kriteret mjekësore për caktimin e aftësisë në punë të invalidëve:

Në vartësi të shkallës së humbjes të aftësisë për punë, sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, invaliditeti klasifikohet në tri grupe:

- a)** Invaliditet i pjesshëm, kur personi i siguruar humbet aftësinë për punë në profesionin apo punën e tij të fundit, por mund të kryejë punë të tjera sipas përcaktimit të vendimit të KMCAPI-t;
- b)** Invaliditet i reduktuar, kur personi i siguruar bëhet i paaftë për çdo punë;
- c)** Invaliditet i plotë në kushtet e nevojës për kujdestari.

3. Kushtet e përfitimit:

- a)** Merr pension invaliditeti të plotë personi i siguruar që ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit. Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror;

- b)** Personi, që është në kushtet e invaliditetit të plotë, por që nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit, ka të drejtë për pension invaliditeti të reduktuar, në masën që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti;
- c)** Të ketë humbur plotësisht aftësinë për punë, jo për shkak të aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale;
- d)** E drejta për të përfituar pension invaliditeti të plotë fillon pas mbarimit të periudhës 6 mujore të trajtimit me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë. Vlerësimi nga KMCAP duhet të bëhet në muajin e pestë ose të gjashtë, para përfundimit të kësaj periudhe.

4. Masa e përfitimit:

- a)** Masa mujore e pensionit të plotë të invaliditetit përbëhet nga pensioni bazë dhe nga një shtesë pensioni që llogaritet si pensioni i pleqërisë. Shuma bazë e pensionit iu jepet gjithë personave të siguruar;
- b)** Shtesa që iu jepet personave të punësuar, është 1 % për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësueshme neto, që i siguruari ka arritur nëpërmjet kontributeve gjatë gjithë historisë së tij kontributive;
- c)** Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi.

7. E ardhura shtesë për kujdesje sipas Nenit 38, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

Kur përfituesi i një pensioni të plotë të invaliditetit bëhet i paaftë dhe ka nevojë për një kujdesje të vazhdueshme nga një person tjetër, sipas përcaktimit të KMCAP-it, atij i jepet një pagesë shtesë prej 15 % të bazës së vlerësueshme neto.

8. E ardhura shtesë për fëmijët në ngarkim sipas Nenit 38, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

Një person i siguruar i paaftë, që merr pension invaliditeti të plotë, sipas Nenit 35, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ka fëmijë në ngarkim deri në moshën 18 vjeç, ose deri në moshën 25 vjeç kur vazhdon studimet e larta me shkëputje nga puna, do të marrë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 % të pensionit bazë, por jo më shumë se 30 % e tij.

I.5 PENSIONI I REDUKTUAR I INVALIDITETIT

Personi që bëhet i paaftë për çdo veprimtari ekonomike dhe ka gjymtime të forta e dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin), ka të drejtë të marrë pension invaliditeti të reduktuar.

1. Baza ligjore:

- a)** Neni 35; 36; 37/1; 38; 39,39/1 i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

- b)** Rregullore e përbashkët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, datë 30.05.2003 “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e KMCAP-it të invalidëve”.

2. Kushtet e përfitimit:

- a)** Kur personi ka humbur plotësisht aftësinë për punë, jo për shkak të një aksidenti në punë apo sëmundjes profesionale;
- b)** Kur personi nuk ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit, e cila është në varësi të raportit të periudhës të sigurimit faktike me periudhën e sigurimit që i duhet për pensionin reduktuar të invaliditetit;
- c)** E drejta për të përfituar pension të reduktuar invaliditeti fillon pas mbarimit të periudhës 6-mujore të trajtimit me raport mjekësor për paaftësi të përkohëshme në punë. Vlerësimi nga KMCAP duhet të bëhet në muajn e pestë ose të gjashtë, para përfundimit të kësaj periudhe.

3. Masa e përfitimit:

- a)** Masa mujore e pensionit të plotë të invaliditetit përbëhet nga pensioni bazë dhe nga një shtesë pensioni që llogaritet si pensioni i pleqërisë. Shuma bazë e pensionit iu jepet gjithë personave të siguruar;
- b)** Shtesa që iu jepet personave të punësuar, është 1% për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësueshme neto, që i siguruari ka arritur nëpërmjet kontributeve gjatë gjithë historisë së tij kontributive;
- c)** Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75% e pagës minimale neto në shkallë vendi.
- d)** Masa mujore e pensionit të reduktuar të invaliditetit është e barabartë me masën e pensionit të reduktuar të invaliditetit të llogaritur sipas pikës “a” shumëzuar me raportin e viteve të periudhave të sigurimit, që janë periudhat e sigurimit që i duhen për pension të reduktuar të invaliditetit.

4. E ardhura shtesë për kujdesje sipas nenit 38, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kur përfituesi i një pensioni të reduktuar të invaliditetit bëhet i paaftë dhe ka nevojë për një kujdesje të vazhdueshme nga një person tjetër, sipas përcaktimit të KMCAP-it, atij i jepet një pagesë shtesë prej 15 % të bazës së vlerësueshme neto.

5. E ardhura shtesë për fëmijët në ngarkim:

Një person i siguruar i paaftë, që merr pension invaliditeti të reduktuar, sipas nenit 35, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ka fëmijë në ngarkim deri në moshën 18 vjeç, ose deri në moshën 25 vjeç kur vazhdon studimet e larta me shkëputje nga puna, do të marrë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 % të pensionit bazë, por jo më shumë se 30 % e tij.

I.6 PENSIONI I PJESSHËM I INVALIDITETIT

Personi që bëhet i paaftë për çdo veprimtari ekonomike dhe ka gjymtime të forta e dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin), ka të drejtë të marrë pension të pjesshëm invaliditeti.

1. Baza ligjore:

- a)** Neni 35; 36; 37; 39,39/1 i Kreut të III-të, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b)** Rregullorja e përbashkët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, datë 30.05.2003 “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e KMCAP-it të invalidëve”.

2. Kushtet e përfitimit:

- a)** Të ketë siguruar periudhën minimale të sigurimit sipas nenit 35, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b)** Merr pension invaliditeti të pjesshëm personi i siguruar që ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit. Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror;
- c)** Të ketë humbur plotësisht aftësinë për punë, jo për shkak të aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale;
- d)** E drejta për të përfituar pension të pjesshëm invaliditeti fillon pas mbarimit të periudhës 6-mujore të trajtimit me raport mjekësor për paaftësi të përkohëshme në punë. Vlerësimi nga KMCAP duhet të bëhet në muajn e pestë ose të gjashtë, para përfundimit të kësaj periudhe.

3. Masa e përfitimit:

- a)** Masa mujore e pensionit të pjesshëm të invaliditetit përbëhet nga pensioni bazë dhe nga një shtesë pensioni që llogaritet si pensioni i pleqërisë. Shuma bazë e pensionit iu jepet gjithë personave të siguruar;
- b)** Shtesa që iu jepet personave të punësuar, është 1 % për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësueshme neto, që i siguruari ka arritur nëpërmjet kontributeve gjatë gjithë historisë së tij kontributive;
- c)** Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi.
- d)** Pensioni i invaliditetit të pjesshëm është sa 50 për qind e pensionit të plotë të invaliditetit. Ai llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i plotë i invaliditetit.

SHQYRTIMI I KËRKESËS DHE VLERËSIMI I I AFTËSISË PËR PUNË NGA KMCAP-I PËR PENSIONET E INVALIDITETIT:

- Të plotë;
- Të reduktuar;
- Të pjesshëm.

- a)** Dokumentacioni i mëposhtëm i dorëzohet mjekut të ekspertizës, i cili pas verifikimit të

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

nevojshëm njofton datën për të kaluar në KMCAP, ose i kthen mbrapsht dokumentat për pasaktësi;

- b)** KMCAP në mbledhjen e tij shqyrton paraprakisht dokumentat, njofton dhe egzaminon të sëmurin, merr vendimin përkatës jo në prani të tij, dhe kryetari i KMCAP-it ia komunikon zyrtarisht të sëmurit gojarisht dhe nëpërmjet vërtetimit tip;
- c)** Kundër këtij vendimi i sëmuri ose invalidi mund të ankohet tek KMCAP-i epror. Ankesa bëhet me shkrim dhe dorëzohet në DRSSH përkatëse.

DOKUMENTACIONI PËR PENSIONET E INVALIDITETIT:

- Të plotë;
- Të reduktuar;
- Të pjesshëm.

14

Për të përfituar pension invaliditeti të plotë, të reduktuar dhe të pjesshëm, përfituesi ose i autorizuari me prokurë paraqitet në ALSSH të vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfitimit të pensionit të invaliditetit.

Përfituesi për pension invaliditeti ose i autorizuari me prokurë, së bashku me kërkesën duhet të paraqesë dhe dokumentat e mëposhtme:

a) Dokumentat që vërtetojnë moshën dhe identitetin:

- Fotokopje e Kartës së identitetit;
- Çertifikatë e gjendjes familjare;
- Çertifikatë martese (vetëm për aplikueset femra);
- Dy fotografi.

b) Dokumentat që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës janë:

- Libreza e punës;
- Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj;
- Vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore;
- Vendim gjykate për njohje të vjetërsisë në punë (nëse periudha e punës nuk provohet me dokumente zyrtare);
- Vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët;
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë (kur kanë mbaruar studimet e larta, me shkëputje nga puna).

c) Dokumentat që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:

- Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip (nëse ka punuar dhe ka derdhur kontribute për periudhat pas datës 01.01.1994);
- Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton pagën ose derdhjen e periudhave kontributive.

d) Dokumentat që vërtetojnë gjendjen shëndetësore:

- Fletë-drejtimi për në KMCAP, lëshuar nga institucione shëndetësore me shtretër, (Spital), shoqëruar me fletë-dalje nga spitali, ekzaminime e dokumenta të tjera plotësuese, të kërkuara kur del për herë të parë në KMCAP;
- Fletë-drejtimi nga KML për ato gjendje shëndetësore, që nuk janë objekt trajtimi në spital,

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

sipas përcaktimit në Rregullore;

- Epikrizë përcjellëse, lëshuar nga mjekë specialistë, apo konsulta e shoqëruar me egzaminimet e nevojshme. Kur del për rikontroll duhet shoqëruar me egzaminimet përkatëse zyrtare;
- Kartela personale dhe libri i shëndetit për të vërtetuar ecurinë e sëmundjes, ndjekjen dhe trajtimin mjekësor me ilaçe;
- Fletë-drejtimi për KMCA, që vërteton rëndimin e gjëndjes shëndetësore, e vlefshme për KMCA, para afatit të rikontrollit;
- Raport mjekësor lëshuar nga Komisioni Mjekësor, që përcakton gjëndjen shëndetësore dhe aftësinë për punë (para fillimit të punësimit ose të përfshirjes në çdo skemë sigurimi);
- Raport mjekësor i lirimit nga ushtria, lëshuar nga KMU pranë SQU, për ushtarët që bëhen invalidë gjatë shërbimit ushtarak;
- Vërtetim për pagesën e paaftësisë për punë, shkaktuar nga një sëmundje e përgjithshme (për punëmarrësin).

15

I.7 PENSIONI FAMILJAR

1. Baza ligjore:

- a)** Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b)** Rregullore nr.1 datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar.

2. Kushtet e përfitimit:

- a)** E veja, kur është:
 - Mbajtëse e një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç;
 - E paaftë për punë;
 - Ka mbushur moshën 55 vjeç.
- b)** Burri i ve, kur është:
 - Mbajtës i një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç;
 - I paaftë për punë;
 - Ka mbushur moshën 60 vjeç.
- c)** Jetimi që ishte në ngarkim të personit që vdiq dhe është nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, nëse studion ose është i paaftë për punë;
- d)** Prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë, prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t’i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë;
- e)** Nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënë pjesë në të njëjtën familje me të. Në këtë rast ata trajtohen si jetimë;
- f)** E/I veja humbasin të drejtën për pension familjar kur martohen.

3. Dokumentacioni:

Kërkesa për përfitimin e pensionit familjar bashkë me dokumentat e nevojshme paraqitet në

ALSSH-në e vendbanimit, sipas gjendjes civile. Dokumentat që shoqërojnë kërkesën për pension familjar janë si më poshtë:

a) Dokumentat që vërtetojnë moshën dhe identitetin:

- Çertifikatë e gjendjes familjare;
- Çertifikatë vdekjeje e të ndjerit/të ndjerës (ku të jetë shënuar dhe shkaku i vdekjes);
- Fotokopje e Kartës së identitetit për kërkuesin, ose përfituesit e tjerë.

b) Dokumentat që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës janë:

- Libreza e punës;
- Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj;
- Vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore;
- Vendim gjykate për njohje të vjetërsisë në punë (në se shikohet e arsyeshme);
- Vërtetim i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj);
- Vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët.

c) Për personat që përfitojnë nga Ligji nr. 7514, datë 30.09.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe reabilitimin e ish-të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë" duhen edhe:

- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim për kohën e vuajtjes së dënimit, lëshuar nga Ministria e Rendit Publik;
- Vërtetim për faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij, të lëshuar nga Komisioni i Ministrisë së Rendit Publik dhe Ministrisë së Drejtësisë;
- Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton qënien në punë.

d) Dokumentat që vërtetojnë të qëniet në ngarkim të të ndjerit/ndjerës:

Krahas dokumentave të përcaktuara më lart, duhet të dorëzohen dhe dokumentat e mëposhtëme:

- Vërtetim i vazhdimit të shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar;
- Vendim i KMCAPI-t për paaftësinë në punë të personave të familjes në ngarkim të të siguruarit të vdekur, kur ata janë në moshë pune;
- Vërtetim i organeve të pushtetit lokal që në ngarkim të të vdekurit ishte një i/e ve, që mban një fëmijë deri në moshën 8 vjeç, i cili ishte në ngarkim të të vdekurit;
- Vërtetim për personin e ve, që është kërkues për punë;
- Proces-verbal, që provon faktin e vdekjes nga aksidenti në punë, si dhe vendimi i KMCAPI, kur vdekja është shkaktuar nga sëmundje profesionale;
- Vërtetim i organeve të pushtetit lokal që prindërit, prindërit e prindërve nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë dhe jetonin në të njëjtën familje me atë që ka vdekur, jo më pak se një vit para vdekjes;
- Vërtetim nga organet e prokurorisë ose gjykatës për rastet kur kërkohet të përfitohet nga Dekreti nr. 758, datë 01.04.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut";
- Vërtetim nga ministria përkatëse për humbjen e jetës së pilotit në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit. Për të marrë këtë përfitim, personi duhet të bëjë kërkesë me shkrim pranë ALSSH-së, ku të deklarojë se nuk është ekonomikisht aktiv (i punësuar ose i vetëpunësuar);
- Jetimi që ka moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar, kur nuk vazhdon shkollën

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

dhe është nën 18 vjeç (kur banon në qytet) dhe nën 16 vjeç (kur banon në fshat), në kërkesën për pension deklaron se nuk është i punësuar ose i vetëpunësuar si dhe paraqet vërtetim nga Zyra e Punës.

e) Dokumentat që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:

- Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip (nëse ka punuar dhe ka derdhur kontribute për periudhat pas datës 01.01.1994);
- Vërtetim i pagës mesatare neto, për vitin e fundit të punës.

4. Masa e përfitimit:

Pensioni familjar është pjesë e pensionit që kishte ose i takonte të ndjerit.

- a)** Personi i ve, merr 50 % të pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndieri, kur është i vetëm dhe për çdo pjestar tjetër merr 25 %, me kusht që shuma e pensionit të mos kalojë 100 përqind, masën e tij;
- b)** Kur e veja nuk është pjestare e pensionit familjar, dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50 % e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri;
- c)** Kur e veja nuk është pjestare e pensionit familjar, dhe përfitues janë dy ose më shumë persona, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25 %, por jo më shumë se 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri;
- d)** Shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes;
- e)** Jetimi merr pension familjar edhe nëqoftëse prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij. Në këtë rast masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25 % e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50 % e tij;
- f)** Jetimi që humbet të dy prindërit merr një pension jetimi për secilin prej tyre;
- g)** Kërkesën për vazhdimin e pensionit familjar, kur mbaron afati i pagesës, përfituesi e paraqet në ALSSH-në e vendbanimit, sipas gjendjes civile duke i bashkangjitur dokumentacionin e kërkuar.

I.8 PENSIONI SOCIAL

Pensioni social është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura, ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social.

1. Baza ligjore:

Neni 5/1, i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH", të ndryshuar.

2. Kushtet e përfitimit:

- Moshë 70 vjeç;
- Qëndrimi i përhershëm në Shqipëri, të paktën për 5 vitet e fundit;
- Nuk plotësohen kushtet për asnjë pension nga skema e detyrueshme;
- Nuk ka të ardhura ose janë më të pakta se një pension social.

3. Dokumentacioni:

- Fotokopje e Kartës së identitetit;
- Certifikatë familjare;
- Deklaratë për gjendjen social-ekonomike;
- Vërtetim nga zyra e gjëndjes civile, që është banor në Shqipëri për të paktën 5 vite, nga koha që paraqet kërkesën;
- Vërtetim nga organet tatimore, nëse ushtron ose jo veprimtari ekonomike;
- Certifikatë pronësie dhe/ose akti i marrjes në pronësi/në përdorim të tokës;
- Vërtetim për ndihmën ekonomike;
- Deklaratë nëse je aksionar apo bashkëpronar në aktivitete ekonomike/ pasuri të patundshme, që nxjerr të ardhura.

Masa e përfitimit:

- a)** Masa e pensionit social është e barabartë me të ardhurat minimale që sigurohen nga pensioni i pjesshëm i pleqërisë me 15 vite të siguruara me pagë minimale, i llogaritur në datën 31.12.2014;
- b)** Masa e pensionit social për personat që kanë të ardhura nga burime të tjera do të jetë sa diferenca e pensionit social me të ardhurat e tjera që ka përfituesi;
- c)** Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pensionin social përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

KUJTESË

- a)** Përfituesi duhet të paraqesë një herë në vit deklaratën për gjendjen social- ekonomike;
- b)** Pensioni social tërhiqet nga përfituesi çdo muaj;
- c)** Pagesa e pensionit social ndërpritet në rast se nuk tërhiqet, në qendrat e përcaktuara të pagesës;
- d)** Pensioni social mbyllet kur konstatohet se ka të dhëna jo të vërteta, lidhur me kushtet ligjore të përfitimit;
- e)** Pensioni social nuk ndërpritet në rastet kur përfituesi është për kurim në spital.

I. 9 PAGESAT PËR VDEKJE (Shpërblim vdekjeje)

4. Baza ligjore:

- a)** Neni 42, i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Kushtet e përfitimit:

Pagesa për vdekje i jepet:

- a)** Një personi të siguruar ose një pensionisti në rast vdekjeje të një anëtari të familjes, që ai ka në ngarkim;
- b)** Personit që u kujdes për personin e siguruar të vdekur, dhe që pagoi shpenzimet e varrimit.

6. Dokumentacioni:

- a)** Çertifikata e vdekjes;

- b) Akti i varrimit;
- c) Libreza e pensionit.

7. Masa e përfitimit:

- a) Pagesa për rast vdekjeje është e barabartë me 50 për qind të pagës minimale në shkallë vendi.

II. KREU I DYTË

PËRFITIMET NGA DEGA E SIGURIMIT TË SËMUNDJEVE

1. Baza ligjore:

- a) Neni 20; 21; 22; 23; 24; 25, i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b) Rregullore nr. 37, e ISSH-së, datë 23.12.2004 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e përfitimeve afatshkurtëra”;
- c) Rregullore nr. 494, e ISSH-së, datë 05.10.1993 “Për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohëshme në punë”.

2. Kushtet e përfitimit:

- a) **Pagesë për paaftësi nga sëmundjet** përfitojnë vetëm të punësuarit;
- b) 14 ditëshi i parë paguhet nga ana e subjektit ku punon përfituesi;
- c) Mbi ditën e 14-të të raporteve, të cilat jepen nga Komisioni Mjeko-Ligjor (KML), raportet paguhen nga sigurimet shoqërore, por gjithmonë llogaritjet e raporteve bëhen nga subjekti.
- d) Raporti mjekësor paguhet deri në 6 muaj gjithsej, duke përfshirë dhe pagesën prej 14 ditësh.

3. Dokumentacioni:

I punësuarit duhet të dorëzojë pranë subjektit ku punon këto dokumenta:

- a) Raportet mjekësore;
- b) Librezën e punës;
- c) Formularin e bazës së vlerësuar neto të 6 muajve paraardhës. (Ky dokument plotësohet nga sektori i financës së subjektit);
- d) Sektori i financës së subjektit, mbështetur në dokumentat e pikës “a”, plotëson formularin tip-“Listëpagesë e përfitimeve afatshkurtra”, dhe e dërgon atë në ALSSH-në, ku ka aktivitetin subjekti;
- e) ALSSH pasi kontrollon dhe verifikon dokumentat e sjella, i kalon pagesat në llogarinë personale të përfituesit, ose në llogarinë e subjektit.

Masa e përfitimit:

- a) 70 % e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të 6 muajve të fundit nga data e lindjes se te drejtes. kur i siguruari ka deri në 10 vjet periudha sigurimi;
- b) 80 % e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të 6 muajve fundit nga data e lindjes se te drejtes, kur i siguruari ka mbi 10 vjet periudha sigurimi.

III. KREU I TRETË

PËRFITIMET NGA DEGA E SIGURIMIT TË BARRËLINDJEVE

1. Baza ligjore:

- a) Neni nr. 26; 27; 28; 29, i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) Rregullore nr. 37, e ISSH-së, datë 23.12.2004 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e përfitimeve afatshkurtra”;
- c) Rregullore nr. 494, e ISSH-së, datë 05.10.1993 “Për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohëshme në punë”.

2. Kushtet e përfitimit:

- a) Për të përfituar lejen e lindjes duhet të kesh 12 muaj periudha sigurimi për çdo rast barrëlindjeje. Përfshihet nga ky rregull rasti kur e drejta e pagesës për barrëlindjen e rradhës ndodh brenda 24 muajve, nga data e lindjes së mëparshme;
- b) Të jesh i siguruar në momentin e lindjes të kësaj të drejte.
- c) Periudha e përfitimit 365 dite kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 35 ditësh para dhe 63 dite pas lindjes së fëmijës.
- d) Pas periudhës prej 63 ditësh pas lindjes, për kujdesin ndaj fëmijës e ka dhe babai i siguruar kur këto të drejta nuk e ushtron opo nuk ka kushte për ta përfituar nëna.

3. Dokumentacioni:

Përfituesja e lejes së lindjes, e punësuar, duhet të dorëzojë pranë subjektit ku punon këto dokumenta:

- Raportet e lindjes;
- Çertifikatën e lindjes së fëmijës;
- Çertifikatën familjare;
- Librezën e punës;
- Formularin e bazës së vlerësuar neto të vitit paraardhës nga data e lindjes së te drejtes (ky dokument plotësohet nga sektori i financës së subjektit);
- Sektori i financës së subjektit, mbështetur në këto dokumenta, plotëson formularin tip-Listë-pagesë e përfitimeve afatshkurtra, dhe e dërgon atë në ALSSH-në, ku ka aktivitetin subjekti;
- ALSSH, pasi kontrollon dhe verifikon dokumentat, i kalon pagesat në llogarinë personale të përfitueses, ose në llogarinë e subjektit;
- Përfituesja e vetëpunësuar, dokumentat e plotësuar do t'i dorëzojë direkt pranë ALSSH, ku dhe bëhen llogaritjet. Pagesa kryhet nga Sigurimet Shoqërore.

4. Masa e përfitimit:

- Për periudhën e paralindjes dhe 150 ditë pas lindjes, për gruan e punësuar është 80% e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të vitit të fundit nga data e lindjes së te drejtes;
- Për gruan e punësuar, për periudhën tjetër në vazhdim deri sa të plotësojë 12 muaj gjithsej sipas kushteve të përfitimit është 50 % e mesatares ditore të bazës së vlerësuar

IV. KREU I KATËRT

PËRFITIMET NGA DEGA E SIGURIMIT TË AKSIDENTEVE NË PUNË DHE SËMUNDJEVE PROFESIONALE

I siguruari që për shkak të aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale, humbet aftësinë për punë, do të përfitojë:

- A.** Të ardhura për paaftësi të përkohëshme nga aksidenti në punë, apo sëmundja profesionale;
- B.** Të ardhura për invaliditet të përhershëm nga aksidenti në punë, apo sëmundja profesionale,
- C.** Të ardhura për invaliditet të pjesshëm të përhershëm nga aksidenti në punë, apo sëmundja profesionale,
- D.** Të ardhura për paaftësi të përhershme në masë të vogël, nga aksidenti në punë apo sëmundja profesionale.

A. TË ARDHURAT PËR PAAFTËSI TË PËRKOHËSHME NGA AKSIDENTET NË PUNË APO SËMUNDJET PROFESIONALE

1. Baza ligjore:

- a)** Kreu i IV, Nenet 43; 44; 45; 46; 47; 48; 49; 50; 51; 52, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;
- b)** VKM nr. 788, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës”;
- c)** VKM nr. 396, datë 28.06.2007 “Për përcaktimin e sëmundjeve profesionale”;
- d)** Rregullore nr. 37, e ISSH-së, datë 23.12.2004 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e përfitimeve afatshkurtra”;
- e)** Rregullore nr. 494, e ISSH-së, datë 05.10.1993 “Për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohëshme në punë”;
- f)** Udhëzimi nr. 1, i ISSH-së, datë 24.09.1993 “Për kriteret e caktimit të aftësisë për punë të invalidëve nga aksidentet në punë”;
- g)** Rregullore nr. 7, e ISSH-së, datë 16.06.1994 “Për kujdes mjekësor shtesë dhe aftësim për dëmtim të vogël dhe zhdëmtime në masë të arsyeshme”.

2. Kushtet e përfitimit:

- a)** Pagesë për paaftësi të përkohëshme nga aksidenti në punë ose sëmundjet profesionale, përfitojnë vetëm të punësuarit;
- b)** Ky raport jepet nga Spitali ose KML, deri në 12 muaj.

3. Dokumentacioni:

- a)** Raportet mjekësore për aksident në punë;
- b)** Proces-verbali tip i aksidentit në punë, i cili plotësohet nga subjekti dhe konfirmohet nga Inspektoriati Shtetëror i Punës;
- c)** Formulari i bazës së vlerësuar neto të 6 muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

(Ky dokument plotësohet nga sektori i financës së subjektit);

- d)** Sektori i financës së subjektit, mbështetur në dokumentat e pikës “a”, plotëson formularin tip-listëpagesë të përfitimeve afatshkurtëra dhe e dërgon atë në ALSSH, ku ka aktivitetin subjekti;
- e)** ALSSH, pasi kontrollon dhe verifikon dokumentat, i kalon pagesat në llogarinë personale bankare të përfituesit, ose në atë të subjektit.

4. Masa e përfitimit:

- a)** 100% e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto, të 6 muajve të fundit nga data e lindjes të të drejtës;
- b)** Kjo masë përfitimi vazhdon deri në 12 muaj.

B. TË ARDHURAT PËR INVALIDITET TË PËRHERSHËM NGA AKSIDENTI NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE (PENSION INVALIDITETI I PLOTË)

Për të përfituar pension të përherëshëm invaliditeti, përfituesi ose i autorizuari me prokurë paraqitet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore (ALSSH) të vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfitimit të pensionit të përherëshëm të invaliditetit dhe për të marrë udhëzimet e nevojshme.

1. Baza ligjore:

- a)** Kreu i IV, Neni 48, i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;
- b)** VKM nr. 788, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës”;
- c)** VKM nr. 396, datë 28.06.2007 “Për përcaktimin e sëmundjeve profesionale”;
- d)** Rregullore nr. 37, e ISSH-së, datë 23.12.2004 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e përfitimeve afatshkurtra”;
- e)** Rregullore nr. 494, e ISSH-së, datë 05.10.1993 “Për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohëshme në punë”;
- f)** Udhëzim nr. 1, i ISSH-së, datë 24.09.1993 “Për kriteret e caktimit të aftësisë për punë të invalidëve nga aksidentet në punë”;
- g)** Rregullore nr. 7, e ISSH-së, datë 16.06.1994 “Për kujdes mjekësor shtesë dhe aftësim për dëmtim të vogël dhe zhdëmtime në masë të arësyeshme”.

2. Kushtet për përfitim:

- a)** Pagesë për paaftësi të përherëshme nga aksidenti në punë ose sëmundjet profesionale, përfitojnë vetëm të punësuarit;
- b)** Këtë të drejtë e përfitojnë pasi të kenë marrë pagesën deri në 12 muaj për paaftësi të përkohëshme nga aksidenti në punë, ose sëmundjet profesionale.

3. Masa e përfitimit:

- a)** E ardhura për invaliditet të përherëshëm në punë ose sëmundje profesionale, që ka shkaktuar të paktën humbjen e 67% të aftësisë për punë, e vërtetuar nga KMCAP, është e barabartë me 80% të pagës mesatare të 3 viteve të fundit të punës, por jo më pak se niveli minimal i standartit të jetesës që vendoset nga KM;

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

- b)** Personit që përfiton të ardhura për invaliditet të përhershëm në punë ose sëmundje profesionale dhe ka nevojë për një kujdesje të vazhdueshme nga një person tjetër, sipas vendimit të KMCAP-it, i jepet një pagesë shtesë prej 15% të bazës së vlerësueshme;
 - c)** Nqs ka në ngarkim fëmijë deri në moshën 18 vjeç ose deri në moshën 25 vjeç, kur vazhdon studimet e larta, i jepet një e ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5% të pensionit bazë, por jo më shumë se 30% e tij;
 - d)** Pensioni bazë përcaktohet me VKM.
- C. TË ARDHURAT PËR INVALIDITET TË PJESSHËM TË PËRHERSHËM NGA AKSIDENTI NË PUNË, APO SËMUNDJET PROFESIONALE (PENSION INVALIDITETI I PJESSHËM)**

Për të përfituar pension të pjesshëm të përhershëm invaliditeti, përfituesi ose i autorizuari me prokurë paraqitet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore (ALSSH) të vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfitimit të pensionit të pjesshëm të përhershëm të invaliditetit dhe për të marrë udhëzimet e nevojshme.

23

1. Baza ligjore:

- a)** Kreu i IV, Neni 49, i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;
- b)** VKM nr. 788, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës”;
- c)** VKM nr. 396, datë 28.06.2007 “Për përcaktimin e sëmundjeve profesionale”;
- d)** Rregullore nr. 37, e ISSH-së, datë 23.12.2004 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e përfitimeve afatshkurtra”;
- e)** Rregullore nr. 494, e ISSH-së, datë 05.10.1993 “Për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohëshme në punë”;
- f)** Udhëzim nr. 1, i ISSH-së, datë 24.09.1993 “Për kriteret e caktimit të aftësisë për punë të invalidëve nga aksidentet në punë”;
- g)** Rregullore nr. 7, e ISSH-së, datë 16.06.1994 “Për kujdes mjekësor shtesë dhe aftësim për dëmtim të vogël dhe zhdëmtime në masë të arësyeshme”.

2. Kushtet e përfitimit:

- a)** Pagesë për paaftësi të pjesëshme të përherëshme nga aksidenti në punë ose sëmundjet profesionale përfitojnë vetëm të punësuarit;
- b)** Këtë të drejtë e përfitojnë pasi të kenë marrë pagesën deri në 12 muaj për paaftësi të përkohëshme nga aksidenti në punë, ose sëmundjet profesionale.

D. TË ARDHURAT PËR PAAFTËSI TË PËRHERËSHME NË MASË TË VOGËL NGA AKSIDENTI NË PUNË

E ardhura për paaftësi të përherëshme në masë të vogël, në më pak se 33 %, por më shumë se 10 %, e vërtetuar nga KMCAP, është një shumë të hollash që jepet menjëherë dhe caktohet në përputhje me Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

1. Baza ligjore:

- a)** Kreu i IV, Neni 49, i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

- b)** VKM nr. 788, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës”;
- c)** VKM nr. 396, datë 28.06.2007 “Për përcaktimin e sëmundjeve profesionale”;
- d)** Rregullore nr. 37, e ISSH-së, datë 23.12.2004 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e përfitimeve afatshkurtra”;
- e)** Rregullore nr. 494, e ISSH-së, datë 05.10.1993 “Për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohëshme në punë”;
- f)** Udhëzim nr. 1, i ISSH-së, datë 24.09.1993 “Për kriteret e caktimit të aftësisë për punë të invalidëve nga aksidentet në punë”;
- g)** Rregullore nr. 7, e ISSH-së, datë 16.06.1994 “Për kujdes mjekësor shtesë dhe aftësim për dëmtim të vogël dhe zhdëmtime në masë të arsyeshme”.

2. Kushtet e përfitimit:

- a)** E ardhura për paaftësi të përhershme në masë të vogël, në më pak se 33%, por më shumë se 10%, e vërtetuar nga KMCAP, është një shumë të hollash që jepet menjëherë dhe caktohet në përputhje me Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- b)** Këtë pagesë e përfitojnë vetëm të punësuarit që janë aksidentuar dhe kanë paaftësi të përhershme në masë të vogël;
- c)** Kjo e drejtë hyn në fuqi pas vendimit të KMCAP-it.

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURAT PËR TË ARDHURAT E INVALIDITETIT NGA AKSIDENTI NE PUNE DHE SËMUNDJET PROFESIONALE:

- Të përhershëm;
 - Të pjesshëm;
 - Në masë më të vogël se aksidenti në punë.
- a) Dokumentat që vërtetojnë moshën dhe identitetin:**
- Fotokopje e letërnjoftimit elektronik, ose certifikatë lindjeje me fotografi;
 - Çertifikatë e gjëndjes familjare;
 - Çertifikatë martese (vetëm për aplikueset femra);
 - Dy copë fotografi.
- b) Dokumentat që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës janë:**
- Libreza e punës;
 - Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj;
 - Vërtetim për periudhën e sigurimit, të lëshuar nga zyra e arkivit pranë Drejtorisë DRSSH-së për punëdhënësit, të punësuarit, të vetëpunësuarit, të vetëpunësuarit në bujqësi;
 - Të gjitha këto dokumenta për efekt përfitimi pensioni invaliditeti do të pranohen kur personi nuk ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë.
- c) Dokumentat që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:**
- Vërtetim page për tri vitet e punës, deri në momentin e aksidentit në punë, ose të sëmundjes profesionale, të vërtetuar nga DRSSH, për derdhjen e kontributit për periudha sigurimi;
 - Çdo dokument tjetër justifikues që vërteton pagën ose derdhjen e periudhave kontributive.

d) Dokumentat që vërtetojnë gjendjen shëndetësore:

- Fletë-drejtimi për në KMCAJ, lëshuar nga institucione shëndetësore me shtretër, (Spital), shoqëruar me fletë-dalje nga spitali, ekzaminime e dokumenta të tjera plotësuese, të kërkuara kur del për herë të parë në KMCAJ;
- Fletë-drejtimi nga KML për ato gjëndje shëndetësore, që nuk janë objekt trajtimi në spital, sipas përcaktimit në Rregullore;
- Epikrizë përcjellëse, lëshuar nga mjekë specialistë, apo konsulta e shoqëruar me egzaminimet e nevojshme. Kur del për rikontroll duhet shoqëruar me egzaminimet përkatëse zyrtare;
- Kartela personale dhe libri i shëndetit për të vërtetuar ecurinë e sëmundjes, ndjekjen dhe trajtimin mjekësor me ilaçe;
- Fletë-drejtimi për KMCAJ, që vërteton rëndimin e gjëndjes shëndetësore, e vlefshme për KMCAJ, para afatit të rikontrollit;
- Raport mjekësor lëshuar nga Komisioni Mjekësor, që përcakton gjëndjen shëndetësore dhe aftësinë për punë (para fillimit të punësimit ose të përfshirjes në çdo skemë sigurimi);
- Raport mjekësor i lirim nga ushtria, lëshuar nga KMU pranë SQU, për ushtarët që bëhen invalidë gjatë shërbimit ushtarak;
- Vërtetim për pagesën e paaftësisë së përkohëshme në punë nga aksidenti në punë, ose sëmundje profesionale;
- Kopje e proces-verbalit për aksident në punë, ose sëmundje profesionale, që është mbajtur në momentin e aksidentit, e legalizuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore.

3. Shqyrtimi i kërkesës dhe vlerësimi i aftësisë në punë nga KMCAJ-i:

- a)** Dokumentacioni i mësipërm i dorëzohet mjekut të ekspertizës, i cili pas verifikimit të nevojshëm njofton datën për të kaluar në KMCAJ, ose i kthen mbrapsht dokumentat për pasaktësi;
- b)** KMCAJ në mbledhjen e tij shqyrton paraprakisht dokumentat, njofton dhe egzaminon të sëmurin, merr vendimin përkatës jo në prani të tij, dhe kryetari i KMCAJ-it ia komunikon zyrtarisht të sëmurit gojarisht dhe nëpërmjet vërtetimit tip;
- c)** Kundër këtij vendimi i sëmuri ose invalidi mund të ankohet tek KMCAJ-i epror. Ankesa bëhet me shkrim dhe dorëzohet në DRSSH përkatëse.

4. Masa e përfitimit:

- a)** E ardhura për invaliditet të pjesshëm të përhershëm në punë, që ka shkaktuar të paktën humbjen e 33 % të aftësisë për punë, e vërtetuar nga KMCAJ, është e barabartë me një pjesë të 80 % të pagës mesatare të 3 viteve të fundit, në vartësi nga shkalla e humbjes së aftësisë për punë, por jo më pak se 50 % të saj, dhe përcaktohet në Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

E. SHPËRBLIMI I LINDJES

1. Baza ligjore:

- a) Neni 29, i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Dokumentacioni:

- a) Certifikata e lindjes së fëmijës;
- b) Libreza e periudhës kontributive;
- c) Vërtetimi i vjetërsisë në punë dhe derdhjet kontributive.

3. Kushtet e përfitimit:

- a) Shpërblimi për lindje fëmije i paguhet një personi të siguruar, i cili është nëna ose babai i fëmijës që lind, me kusht që njëri prej tyre të ketë kontribuar për një vit para lindjes së fëmijës;
- b) Shpërblimi bëhet i pagueshëm vetëm një herë dhe nëna do të ketë parësi në përfitimin e pagesës, në rast se ajo është e siguruar.

4. Masa e përfitimit:

- a) Shpërblimi për çdo fëmijë të lindur do të jetë një shumë e barabartë me 50% të pagës minimale mujore, të miratuar me VKM, në momentin e lindjes të së drejtës.

F. PAGESË VDEKJEJE

1. Baza ligjore:

- a. Neni 42, i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Kushtet e përfitimit:

Pagesa për vdekje i jepet:

- b. Një personi të siguruar ose një pensionisti në rast vdekjeje të një anëtari të familjes, që ai ka në ngarkim;
- c. Personit që u kujdes për personin e siguruar të vdekur, dhe që pagoi shpenzimet e varrimit.

3. Dokumentacioni:

- a. Certifikata e vdekjes;
- b. Akti i varrimit;
- c. Libreza e pensionit.

4. Masa e përfitimit:

- a. Pagesa për rast vdekjeje është e barabartë me 50 për qind të pagës minimale në shkallë vendi.

PËRFITIMET QË FINANCOHEN NGA BUXHETI I SHTETIT DHE LLOGARITEN NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

A. PENSIONET E POSAÇME SHTETËRORE

Pensioni i posaçëm shtetëror është një shtesë që jepet me Vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

1. Baza ligjore:

- a) Neni 5, i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) VKM nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”, i ndryshuar.

2. Kush e përfiton pensionin e posaçëm shtetëror:

Pensionin e posaçëm shtetëror e përfitojnë ata persona që:

- a) Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brënda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;
- b) Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;
- c) Kanë vuajtur nga persekutimi politik nën rregjimin komunist.

3. Procedurat dhe dokumentacioni që nevojitet për të përfituar pension të posaçëm shtetëror:

- a) Kërkesa, propozimi për përfitimin ose shtesën e pensionit të posaçëm shtetëror bëhet nga:
 - Personi i interesuar, nëpërmjet Këshillit të Qarkut të vendbanimit të personit;
 - Organizatat ose shoqatat, nëpërmjet Këshillit të Qarkut të vendbanimit të personit;
 - Titullarët e Ministrive, ku punon përfituesi përkatës;
 - Kryeministri;
 - Kryetari i Kuvendit;
 - Presidenti i Republikës.
- b) Kërkesa duhet të përmbajë gjeneralitetet, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen etj. dhe duhet të jetë e shoqëruar me dokumentat, si vijojnë:
 - Fotokopjen e letërnjoftimit elektronik ose certifikatën e gjendjes civile;
 - Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore nëse merr pension dhe masën e pensionit;
 - Vërtetim të KMCAP-it për personat e paaftë për punë;
 - Kopjet e noterizuara të dokumentave që vërtetojnë meritat e veçanta si titujt, medaljet, urdhërat etj;
 - Kopjen e noterizuar të Statusit të të përndjekurit politik.

4. Masa e përfitimit:

Pensionin e posaçëm shtetëror e përfitojnë personat e sipërpërmendur si shtesë mbi pensionin që iu takon nga sigurimet shoqërore, ose si pension nëse nuk përfitojnë pension nga sigurimet shoqërore.

- a) Pensioni i posaçëm shtetëror nuk mund të jetë më i ulët se dyfishi i pensionit social dhe as më i lartë se katërfishi i tij;
- b) Kufiri maksimal i shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror të jetë deri në katërfishin e pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social."

B. PENSIONI PËR MERITA TË VEÇANTA

Pensionin për merita të veçanta është pensioni i caktuar sipas nenit 33, të Ligjit nr. 4171, datë 13.09.1966 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe do të vazhdojë të paguhet nga organet e sigurimeve shoqërore, deri sa përfituesi të vdesë. Sot pensioni për merita të veçanta nuk llogaritet. Ky lloj përfitimi po vjen drejt mbylljes së tij.

C. SHPËRBLIMI I LUFTËS (Shpërblimi i veteranëve)

Shpërblimi i luftës (shpërblim veterani), është një shtesë, që bazohet në Ligje dhe Vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave, dhe iu jepet veteranëve dhe invalidëve të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar.

1. Baza ligjore:

- a) Ligji nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit Shqiptar";
- b) VKM nr. 190, datë 03.05.1995 "Për zbatimin e Ligjit Nr 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit Shqiptar";
- c) VKM nr. 2, datë 10.01.1996 "Për disa ndryshime në VKM Nr. 190, datë 03.05.1995 "Për zbatimin e Ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit Shqiptar".

2. Kush e përfiton:

- a) Të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj, që luftuan kundër pushtuesve nazifashistë nga 7 Prilli i vitit 1939, deri në ditën e çlirimit të Shqipërisë;
- b) Luftëtarët e inkuadruar në ato njësi të ushtrisë, që luftuan jashtë kufijve të Atdheut deri më 09.05.1945;
- c) Të gjithë ata persona që kanë zhvilluar veprimtari të organizuar në ilegalitet, në prapavijë të armikut e në zona të çliruara;
- d) Kryefamiljarët e atëhershëm të shtëpive të njohura si baza të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë;
- e) Të burgosurit dhe të internuarit në burgjet dhe kampet nazifashiste, brenda dhe jashtë vendit;

- f) Shtetasit shqiptarë që kanë marrë pjesë aktive në Luftën kundër nazifashistëve në vende të tjera.

D. PENSIONI PËR INVALID TË LUFTËS

Pensioni për invalid luftime është një pension që bazohet në Ligje dhe Vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave, që iu jepet invalidëve të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit Shqiptar.

1. Baza ligjore:

- a) Ligji nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;
- b) Ligji nr. 7663, datë 20.01.1993 “Për statusin e invalidëve të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;
- c) VKM nr. 326, datë 21.6.1993 “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;
- d) VKM nr. 190, datë 03.05.1995 “Për zbatimin e Ligjit Nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;

2. Kush e përfiton:

Të drejtën e përfitimit nga statusi i invalidit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar e kanë:

- a) Të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj, që janë plagosur dhe gjymtuar duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë nga 7 Prilli i vitit 1939, deri në çlirimin e Shqipërisë;
- b) Luftëtarët e inkuadruar në ato njësi të ushtrisë që janë plagosur dhe gjymtuar duke luftuar jashtë kufijëve të Atdheut deri më 09.05.1945;
- c) Të gjithë personat, që janë plagosur dhe gjymtuar, duke zhvilluar veprimtari të organizuar në ilegalitet, në prapavijë të armikut ose në zonat e çliruara;
- d) Të burgosurit dhe të internuarit, që janë plagosur dhe gjymtuar në burgjet dhe kampet nazifashiste, brenda dhe jashtë vendit.

E. KOMPESIMI I SHPENZIMEVE NGA NDRYSHIMI I ÇMIMIT TE ENERGJISË ELEKTRIKE DHE LËNDËVE DJEGËSE

Kompesimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse në masën 350 dhe 700 lekë, e përfitojnë të gjitha kategoritë e pensioneve të pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare të qytetit, dhe në masën 200 lekë pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, kur përfituesit banojnë në fshat. Pensionistët e fshatit, kur banojnë në qytet, përfitojnë 350 lekë.

1. Baza ligjore:

- a) VKM nr. 138, datë 31.03.1994 “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”;
- b) Udhëzimi nr. 1, i ISSH-së, datë 28.07.1992 “Për zbatimin e VKM nr. 138, datë 31.03.1994 “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”.

2. Dokumentacioni që nevojitet për përfitimin e 350 lekëve:

- a) Deklaratë personale, që plotësohet nga përfituesi pranë Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore, në vendbanimin e tij;
- b) Fotokopje e kontratës të energjisë elektrike nga operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike.

3. Dokumentacioni që kërkohet për përfitimin e shtesës prej 700 lekëve:

- a) Dokumentat e përshkruara në pikën 2; dhe
- b) Çertifikatë familjare, kur ka fëmijë në ngarkim, me kusht që ata të jenë deri në moshën 18 vjeç, dhe kur vazhdojnë shkollën deri në 25 vjeç, duke paraqitur vërtetimin e shkollës. Kur ka persona në ngarkim mbi këtë moshë, duhet të paraqitet dhe vërtetim nga zyrat e punësimit, nga zyra tatimore e Bashkisë dhe komunave dhe nga zyra e tatim-taksave.

4. Dokumentacioni që duhet për përfitimin e 200 lekëve:

- a) Dokumentat e përshkruara në pikën 2.

F. KOMPENSIMI NGA NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË BUKËS, VAJGURIT DHE GAZIT TË LËNGSHËM

1. Kush e përfiton:

- a) Kompesimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm, në masën prej 150 lekësh, e përfitojnë pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe pensionet familjare të qytetit.

2. Baza ligjore:

- a) VKM nr. 471, datë 15.07.1996 “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”;
- b) Udhëzim nr. 5, i ISSH-së, datë 17.07.1996 “Për zbatimin e VKM nr. 471, datë 15.07.1996 “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”.

G. KOMPENSIMI I TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE NË MASËN DERI NË 500 LEKË

1. Kush e përfiton:

- a) Të gjitha pensionet e pleqërisë, të plotë, të pjeshëm, të reduktuar dhe pensionet familjare të plota e të pjeshme të qytetit.

2. Baza ligjore:

- a) VKM nr. 401, datë 21.06.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”;
- b) Udhëzimi Nr. 3, i ISSH-së, datë 07.11.2006 “Për zbatimin e VKM nr. 401, datë 21.06.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”.

3. Masa e përfitimit:

- a) 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pjesëshme të pleqërisë;
- b) 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë;
- c) Deri në 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pleqërisë, që e kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 500 lekë, e cila llogaritet si diferencë ndërmjet kufirit të mësipërm me pensionin e caktuar brenda këtij kufiri;
- d) Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e të ardhurave nga pensioni dhe përfitohet së bashku me pensionin.

H. KOMPENSIMI I TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONEVE TË QYTETIT DERI NË MASËN 760 LEKË

1. Baza Ligjore:

- a) VKM nr. 763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”;
- b) Udhëzimi nr. 5, datë 30.11.2006 “Për zbatimin e VKM nr. 763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”.

2. Kush e përfiton:

- a) Të gjitha pensionet e pleqërisë, të plota, të pjeshme, të reduktuara, pensionet e invaliditetit të plotë, të reduktuar, të pjeshëm dhe pensionet familjare të plota, të pjeshme të qytetit.

3. Masa e përfitimit:

- a) Përfitojnë deri në 760 lekë në muaj, të gjitha pensionet e pjeshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, që përfitojnë një masë pensioni më të vogël se pensioni bazë. Kjo llogaritet si raport i produktit të shumëzimit të pensionit të caktuar me 760 lekë dhe ajo që del pjestohet me pensionin bazë;
- b) Përfitojnë 760 lekë në muaj të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare;
- c) Përfitojnë deri në 760 lekë në muaj të gjitha pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, që e kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 500 lekë, në zbatim të VKM nr. 401, datë 21.06.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve” - plus 760 lekë, e cila llogaritet si diferencë ndërmjet kufirit të mësipërm dhe pensionit të caktuar;

- d) Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e të ardhurave nga pensioni dhe përfitohet së bashku me pensionin.

I. KOMPENSIMI I TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONEVE TË QYTETIT NË MASËN DERI NË 190 LEKË

1. Baza ligjore:

- a) VKM nr. 415, datë 30.04.2009 “Për rritjen e pensioneve”;
- b) Udhëzimi nr. 1, i ISSH-së, datë 30.04.2009 “Për zbatimin e VKM nr. 415, datë 30.04.2009 “Për rritjen e pensioneve”.

2. Kush e përfiton:

- a) Të gjitha pensionet e pjeshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe pensionet e pjesëshme familjare të qytetit;
- b) Të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, invaliditetit dhe familjare të qytetit;
- c) Të gjitha pensionet e pleqërisë dhe familjare të qytetit, pasi t’iu jenë llogaritur të gjitha kompensimet, sipas VKM nr. 401, datë 21.06.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, VKM nr. 763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”.

3. Masa e përfitimit:

- a) Përfitojnë deri në 190 lekë në muaj, të gjitha pensionet e pjeshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, që përfitojnë një masë pensioni më të vogël se pensioni bazë. Kjo llogaritet si raport i shumëzimit të pensionit të caktuar me 190 lekë dhe kjo që del pjestohet me pensionin bazë;
- b) Përfitojnë 190 lekë në muaj të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare;
- c) Përfitojnë deri në 190 lekë në muaj, të gjitha pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, që e kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 500 lekë nga VKM nr. 401, datë 21.06.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, VKM nr. 763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, dhe nga shuma e mësipërme e llogaritur zbritet pensioni i caktuar brenda këtyre kufijve.
- d) Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e të ardhurave nga pensioni dhe përfitohet së bashku me pensionin.

J. KOMPENSIMI I TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONEVE TË QYTETIT NË MASËN DERI NË 200 LEKË

1. Baza ligjore:

- a) VKM nr. 716, datë 18.06.2010 “Për rritjen e pensioneve”;
- b) Udhëzimi nr. 92, datë 20.06.2010 “Për zbatimin e VKM nr 716, datë 18.06.2010 “Për rritjen e pensioneve”.

2. Kush e përfiton:

- a) Të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe pensionet e pjesshme familjare të qytetit;
- b) Të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, invaliditetit dhe familjare të qytetit;
- c) Të gjitha pensionet e pleqërisë dhe familjare të qytetit, pasi t'u jenë llogaritur të gjitha kompensimet, sipas VKM nr. 138, datë 31.03.1994 "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse", VKM nr. 471, datë 15.07.1996 "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm", VKM nr. 401, datë 21.06.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", VKM nr. 763, datë 27.12.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve", që nuk kalojnë kufirin e të ardhurave, sipas pikës c të VKM nr. 415, datë 30.04.2009 "Për rritjen e pensioneve".

3. Masa e përfitimit:

- a) Deri në 200 lekë në muaj, të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, që përfitojnë një masë pensioni më të vogël se pensioni bazë. Kjo llogaritet si raport i produktit të shumëzimit të pensionit të caktuar në momentin e lindjes të të drejtës me 200 lekë dhe kjo që del pjestohet me pensionin bazë të vitit të lindjes së të drejtës;
- b) 195 lekë në muaj të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë të invaliditetit dhe familjare;
- c) Deri në 200 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe familjare, që e kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 500 lekë nga VKM nr. 401, datë 21.06.2006 "Per kompensimin e te ardhurave mujore te pensioneve", plus 760 lekë nga VKM nr. 763, datë 27.12.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve", plus 190 lekë kompesim nga VKM nr. 415, datë 30.04.2009 "Për rritjen e pensioneve", plus 200 lekë kompensim nga VKM nr. 716, datë 18.06.2010 "Për rritjen e pensioneve". Nga kjo shumë zbritet masa e pensionit të përfituar në momentin e lindjes së të drejtës;
- d) Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e të ardhurave nga pensioni dhe përfitohet së bashku me pensionin.

K. KOMPENSIM PËR PERSONAT NË NGARKIM TË PENSIONISTËVE

Ky kompensim jepet për personat në ngarkim që ka përfitusi i pensionit të pleqërisë, invaliditetit dhe familjar.

1. Baza ligjore:

- a) VKM nr. 274, datë 12.06.1993 "Për kompensimin për frymë të shpenzimeve, nga rritja e çmimit të bukës;
- b) VKM nr. 310, datë 24.07.1992 "Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimit të disa artikujve ushqimorë (ndryshuar me VKM nr. 351, datë 10.08.1992 dhe VKM nr. 490, datë 23.11.1992);
- c) VKM nr. 703, datë 27.12.2001 "Për skemën e kompensimit të shpenzimeve nga rritja e çmimit të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë", i ndryshuar;

2. Kush e përfiton:

- a) E përfitojnë të gjithë pensionistët që marrin pension, që kanë anëtarë të familjes në ngarkim dhe që janë me banim të përhershëm në qytet;
- Kur kanë në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën e lartë;
- Kur kanë persona të tjerë në ngarkim dhe nuk janë më në marrëdhënie pune.

3. Masa e përfitimit:

- a) 414 lekë në muaj për çdo person të familjes në ngarkim kur:
 - Fëmijët janë nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën;
 - Nipat, mbesat, kur nuk i kanë prindërit, bashkëjetojnë me pensionistin dhe janë nën moshën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç kur vazhdojnë shkollën.
- b) 207 lekë në muaj, kur një nga prindërit është në marrëdhënie pune, ose në pension.

4. Nuk e përfitojnë:

- a) Pensionistët që realizojnë të ardhura nga veprimtaria ekonomike si të punësuar, punëdhënës, të vetëpunësuar, ose kanë tokë në pronësi.

5. Dokumentacioni që kërkohet:

- a) Fotokopje e letërnjoftimit elektronik për personat përfitues;
- b) Çertifikatë familjare;
- c) Vërtetim nga shkolla;
- d) Vërtetim nga zyra e tatimeve, taksave dhe nga bashkitë dhe komunat, për mospatje të aktivitetit;
- e) Vërtetim nga zyra e punës, si punëkërkuar, për personat që janë në ngarkim dhe nuk janë në marrëdhënie pune;
- f) Deklaratë personale.

L. KOMPENSIMI PËR MBROJTJEN E SHTRESAVE NË NEVOJË NGA RITJIA E ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Ky kompensim përfitohet nga një pjesë e pensionistëve.

1. Baza ligjore:

- VKM nr. 565, datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”;
- VKM nr. 41, datë 07.06.2010 “Për një ndryshim në VKM nr. 565, datë 09.08.2007 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”;
- Udhëzimi nr. 10, I ISSH-së, datë 26.09.2006 “Për zbatimin e VKM nr. 565, datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”.

2. Kush e përfiton:

- a) Kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;

- b) Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror dhe jetojnë të vetëm ose kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura.

3. Dokumentacioni që kërkohet:

- a) Deklaratë personale, që ndodhet, pranë Agjencive Lokale të Sigurimeve Shoqërore;
- b) Fotokopje e kontratës të energjisë elektrike, lidhur midis OSSH-së dhe personit;
- c) Çertifikatë familjare;
- d) Për fëmijët mbi moshën 18 deri në 25 vjeç, vërtetim që vazhdojnë shkollën.

4. Masa e përfitimit:

- a) 640 lekë në muaj. Ky shpërblim tërhiqet në postën paguese së bashku me pensionin.

M. KOMPENSIMI I TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONEVE TË FSHATIT

Kompesimi i të ardhurave mujore të pensionistëve që përfitojnë pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar fshati, deri në 690 lekë në muaj.

1. Baza ligjore:

- a) VKM nr. 17, datë 20.01.2007 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”;
- b) Udhëzim nr. 1, i ISSH-së, datë 20.01.2007 “Për zbatimin e VKM nr. 17, datë 20.01.2007 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”.

2. Kush e përfiton:

- a) Të gjitha pensionet e pleqërisë të plota dhe të pjesëshme;
- b) Të gjitha pensionet e invaliditetit të plota, të reduktuara dhe të pjesëshme;
- c) Të gjitha pensionet familjare të plota dhe të pjesëshme të fshatit.

3. Masa e përfitimit:

- a) Deri në 690 lekë në muaj, të gjitha pensionet e pjesëshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjar, që përfitojnë një masë pensioni më të vogël se pensioni bazë. Kjo llogaritet si raport i produktit të shumëzimit të pensionit të caktuar me 690 lekë dhe prodhimi që del, pjestohet me pensionin bazë të miratuar;
- b) 690 lekë në muaj, të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare;
- c) Deri në 690 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjar, që e kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 690 lekë, dhe nga kjo shumë zbresim pensionin e caktuar brenda këtij kufiri;
- d) Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e pensionit dhe përfitohet së bashku me pensionin.

N. KOMPENSIMI PËR MBROJTJEN E SHTRESAVE NË NEVOJË PËR EFEKT TË HEQJES SË FASHËS SË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DERI NË 300 KWH NË MUAJ

Edhe ky kompensim përfitohet nga një pjesë e pensionistëve.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

1. Baza ligjore:

- a)** VKM nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike, deri në 300 këh në muaj”;
- b)** Udhëzimi nr. 1, datë 02.02.2015 “Për zbatimin e VKM nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike, deri në 300 KËH në muaj”;

2. Kush e përfiton:

- a)** Kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat;
- b)** Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror ose pension pleqërie fshati, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar.

3. Dokumentacioni që kërkohet:

- a)** Deklaratë personale, që ndodhet, pranë Agjencive Lokale të Sigurimeve Shoqërore;
- b)** Fotokopje e nënshkruar e Kartës së identitetit;
- c)** Fotokopje e kontratës të energjisë elektrike, lidhur midis OSSH-së dhe personit;
- d)** Fotokopje e Librezës së energjisë, që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara;
- e)** Çertifikatë familjare;

4. Masa e përfitimit:

- a)** 648 lekë në muaj. Ky shpërblim tërhiqet në postën paguese së bashku me pensionin.

A. SKEMA SUPLEMENTARE E PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE PUNONJËSVE TË SHTETIT

1. Cila është baza ligjore, në mbështetje të së cilës ISSH jep përfitime suplementare shtetërore?

Ligji nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar.

Ndryshimet e Ligjit:

- Ligji nr. 8500, datë 10.06.1999;
- Ligji nr. 9061, datë 08.05.2003;
- Ligji nr. 9827, datë 05.11.2007;
- Ligji nr. 9990, datë 15.09.2008.
- Ligji nr. 27, datë 26.03.2015

2. Cilat janë kushtet bazë për të qenë përfitues të kësaj skeme?

- Të keni kryer funksione kushtetuese apo detyrën si punonjës i shtetit (institucionet qendrore buxhetore), sipas listës që i bashkëngjitet VKM nr. 548, date 27.07.2016
- Të keni paguar kontribute suplementare, duke filluar nga data 01.04.1996.

3. Cilat janë kushtet sipas përfitimeve, që jepen në bazë të këtij Ligji?

a. Pagesa kalimtare.

Kushtet për përfitim:

Të jeni larguar nga funksioni, i cili duhet të jetë klasifikuar në grupin e parë, grupin e dytë, germa “a” sipas përcaktimeve në listën që i bashkëlidhet VKM nr.548, date 27.07.2016

b. Pensionet shtetërore suplementare të pleqërisë.

Kushtet për përfitim.

Për personat e klasifikuar në grupin e parë:

- Të kenë mbushur moshën 60 vjeç ose para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit për sigurimet shoqërore të detyrueshme. Duke filluar nga data 01.01.2032, mosha e përfitimit rritet me nga 6 muaj për çdo vit, deri në arritjen e moshës 63 vjeç.
- Të kenë periudha të njohura shërbimi në një nga funksionet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 8, të nenit 1.
- Të kenë ndërprerë veprimtarinë ekonomike."

Për personat e klasifikuar në grupin e dytë:

- Të kenë kryer 35 vite shërbimi në detyrat ose funksionet e parashikuara nga ky ligj; ose
- të kenë arritur moshën për pension pleqërie, sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ose
- para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Personat, të cilët plotësojnë njërin nga kushtet e sipërpërmendura, duhet të kenë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.

c. Pensionet shtetërore suplementare familjare.

Kushtet për përfitim:

- Përfitojnë pensione familjare nga personi që vdes dhe që përfitonte ose kishte kushte për pension shtetëror suplementar, sipas këtij Ligji, bashkëshorti pasjetues dhe jetimi, kur kanë plotësuar kushtet për pension familjar, sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar.

d. Pensionet shtetërore për personat që aksidentohen në shërbim.

Kushtet për përfitim:

- Kur aksidentoheni në shërbim (shërbim-në kuptim të këtij Ligji) dhe deklaroheni invalidë të përhershëm, sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar.

4. Cili është dokumentacioni që duhet të paraqitet për përfitimet suplementare shtetërore dhe ku duhet të paraqitet ky dokumentacion?

- Paraqituni në strukturat rajonale të sigurimeve shoqërore, ku keni vendbanimin, dhe pajisuni me një format- kërkesë;
- Kërkesës së plotësuar në të gjitha rubrikat, i bashkëlidhet dokumentacioni i renditur më poshtë, sipas llojit të përfitimit.

Kujdes! Për çdo përfitim, data e regjistrimit të kërkesës do të jetë data e paraqitjes së saj, ndërsa kur ajo dërgohet me postë merret parasysh data e vulës postare nga ku është nisur. Kur kjo kërkesë nuk shoqërohet me të gjitha dokumentat e nevojshme, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së saj, njoftoheni për mangësitë e dokumentave që duhet të plotësoni. Në rast se brenda 30 ditëve nga data e njoftimit nuk paraqisni dokumentat plotësuese, atëherë iu kthehen zyrtarisht të gjitha dokumentat e paraqitura, duke bërë shënimet përkatëse në regjistër. Në këtë rast, data e regjistrimit të parë nuk ka vlerë, përse i përket llogaritjes së afatit për fillimin e përfitimit të kërkuar.

a) Për përfitimin e pagesës kalimtare, bashkëlidhur kërkesës duhet të keni:

- Fotokopje të kartës identitetit;
- Vërtetim të pagës referuese (plotësuar nga punëdhënësi);
- Vërtetim të viteve të shërbimit (plotësuar nga punëdhënësi);
- Librezën e kontributeve suplementare, nëse keni;
- Origjinalin e Librezës së punës (nëse jeni i punësuar fotokopje të librezës së punës);
- Nëse jeni i punësuar, vërtetim nga punëdhënësi i fundit për datën e fillimit të punës dhe pagën që përfitoni;
- Deklaratë personale për gjendjen e punësimit.

b) Për përfitimin e pensionit suplementar të pleqërisë, bashkëngjitur kërkesës duhet të keni:

- Fotokopje të kartës identitetit;
- Dëshmi penaliteti;
- Vërtetim të pagës referuese (plotësuar nga punëdhënësi);
- Vërtetim të viteve të shërbimit (plotësuar nga punëdhënësi);
- Librezën e kontributeve suplementare, nëse keni;

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

- Fotokopje të librezës së punës.
- c) Për përfitimin e pensionit suplementar për personat që aksidentohen në shërbim,** bashkëlidhur kërkesës, duhet të jenë:
 - Fotokopje e kartës së identitetit;
 - Dëshmi penaliteti;
 - Procesverbali i mbajtur nga qendra e punës për aksidentin në shërbim;
 - Vërtetim i pagës referuese (plotësuar nga punëdhënësi);
 - Vërtetim i viteve të shërbimit (plotësuar nga punëdhënësi);
 - Vendim i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë;
 - Libreza e kontributeve suplementare, nëse keni;
 - Fotokopja e librezës së punës.
- d) Për përfitimin e pensionit suplementar familjar,** bashkëlidhur kërkesës duhen:
 - Certifikatë familjare;
 - Certifikata e vdekjes së personit, që ka kryer funksione kushtetuese apo detyra në administratën shtetërore;
 - Fotokopje e letërnjoftimit elektronik e përfituesit;
 - Dëshmi penaliteti e të ndjerit;
 - Vërtetim i pagës referuese (plotësuar nga punëdhënësi);
 - Vërtetim i viteve të shërbimit (plotësuar nga punëdhënësi);
 - Libreza e kontributeve suplementare të të ndjerit, nëse keni;
 - Vërtetim i vazhdimit të shkollës për jetimët;
 - Deklaratë për punësimin apo aktivitetin ekonomik.

5. Si bëhet aktualizimi i këtyre përfitimeve?

Pensionet shtetërore suplementare indeksohen. Koha dhe masa e indeksimit përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

B. SKEMA SUPLEMENTARE E USHTARAKËVE

1. Cila është baza ligjore në mbështetje të së cilës jepen përfitimet suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit dhe të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë?

Ligji nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit dhe të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me Ligjin nr.10 367, datë 23.12.2010 "Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e Ligjit nr. 5, datë 10.11.2010, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10 142, datë 15.05.2009".

2. Cilët janë personat që përfitojnë sipas këtij Ligji?

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

- Ushtarakët e Forcave të Armatosura në RSH;
- Punonjësit e Policisë së Shtetit;
- Punonjësit e Gardës së RSH;
- Punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit;
- Punonjësit e Policisë së Burgjeve;
- Punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit;
- Punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm;
- Punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Cilat janë kushtet sipas llojeve të përfitimeve që administrohen nga ISSH-ja?

a) Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

Kushtet për përfitim:

- Për burra: mosha 47 vjeç dhe jo më pak se 15 vite shërbimi;
- Për gra: mosha 42 vjeç dhe jo më pak se 12 vite shërbimi.

b) Pension suplementar i pleqërisë.

Kushtet për përfitim:

- Personat e përmendur në pikën 2 të këtij kreu, që përfitojnë pension pleqërie sipas Ligjit nr. 4171, datë 13.09.1966 “Për sigurimet shoqërore në RPSH” dhe Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar.

c) Pension suplementar i invaliditetit.

Kushtet për përfitim:

- Personat e përmendur në pikën 2 të këtij kreu, kur janë deklaruar invalidë dhe përfitojnë pension invaliditeti të plotë apo të pjesshëm, sipas Ligjit nr. 4171, datë 13.09.1966 “Për sigurimet shoqërore të RPSH” dhe Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar.

d) Pensioni suplementar familjar.

Kushtet për përfitim:

- Kur personat e familjes në ngarkim të personave të përmendur në pikën 2 të këtij kreu, përfitojnë pension familjar, sipas Ligjit nr. 4171, datë 13.09.1966 “Për sigurimet shoqërore në RPSH” dhe Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar.

e) Pensioni suplementar familjar, për personat që humbasin jetën në detyrë apo për shkak të saj

Kushtet për përfitim:

- Personat e përmendur në pikën 2 të këtij kreu, që humbasin jetën në detyrë apo për shkak të saj.

4) Cili është dokumentacioni që duhet të paraqitet për këto lloj përfitimesh dhe ku duhet të paraqitet ky dokumentacion?

- Drejtohuni në **Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore**, ku ju keni vendbanimin, dhe pajisuni me dy format-kërkese;
 - Një format-kërkese e plotësuar paraqitet në strukturat, nga ku keni ndërprerë karrierën ushtarake dhe keni dalë në rezervë/lirim apo pension pleqërie. Mbi bazë të kësaj kërkese, këto struktura dërgojnë në rrugë postare modelarin Nr. 3 “Vërtetim për vjetërsinë në shërbim dhe pagën mesatare neto referuese” në strukturën rajonale të sigurimeve shoqërore, ku keni vendbanimin;
 - Formatit tjetër të kërkesës, plotësuar në të gjitha rubrikat, i bashkëlidhet dokumentacioni i renditur më poshtë, për çdo përfitim, dhe dorëzohet pranë ALSSH, ku keni vendbanimin.
- a) Kujdes!** Për çdo përfitim, data e regjistrimit të kërkesës **është e rëndësishme**. Personi, që kërkon përfitimet jo më vonë se 1 vit nga data kur i lind kjo e drejtë, përfitimi i paguhet nga data e lindjes së të drejtës. Në raste të tjera, përfitimi paguhet nga data e paraqitjes së kërkesës për përfitim.

Për përfitimin e pensionit të parakohshëm, bashkëlidhur kërkesës duhet të jenë:

- Fotokopje e kartës së identitetit;
 - Deklaratë për punësimin (e përvitshme);
 - Vërtetim nga Zyra e Tatim-Taksave;
 - Vërtetim nga zyrat e punës si punëkërkuar;
 - Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive.
- b) Për përfitimin e pensionit suplementar të pleqërisë**, bashkëlidhur kërkesës, duhet të jenë:
- Fotokopje e kartës identitetit;
- c) Për përfitimin e pensionit suplementar të invaliditetit**, bashkëlidhur kërkesës, duhet të jenë:
- Fotokopje e kartës identitetit;
- d) Për përfitimin e pensionit suplementar familjar**, bashkëlidhur kërkesës, duhen:
- Certifikatë familjare;
 - Certifikatë e vdekjes së personit;
 - Fotokopje e kartës identitetit së përfituesit;
 - Vërtetim për vazhdimin e shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t’u punësuar;
 - Deklaratë për punësimin apo aktivitetin ekonomik.
- e) Për përfitimin e pensionit suplementar familjar, kur ushtarakët humbasin jetën në detyrë apo për shkak të saj**, bashkëngjitur kërkesës duhen këto dokumenta:
- Certifikatë familjare;
 - Certifikatë e vdekjes së personit;
 - Fotokopje e kartës identitetit se përfituesit;
 - Vërtetim i vazhdimit të shkollës për jetimët,;
 - Deklaratë për punësimin apo aktivitetin ekonomik.

C. SKEMA E TRAJTIMEVE TË VEÇANTA

Skema e trajtimit të veçantë të punonjësve të nëntokës, minierës.

1. Baza ligjore:

Ligji nr. 8685, datë 09.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokë", i ndryshuar.

2. Ndryshimet:

- Ligji nr. 9356, datë 17.03.2005;
- Ligji nr. 9706, datë 05.04.2007.

3. Personat përfitues:

- Sipas këtij Ligji përfitojnë punonjësit, të cilët kanë punuar në miniera, nëntokë.

4. Lloji i përfitimit:

- Trajtim i veçantë financiar.

5. Kushtet e përfitimit:

- Personat të kenë punuar për një periudhë jo më pak se 11 vjet e gjysëm nëntokë dhe të kenë periudhë të përgjithshme jo më pak se 23 vjet punë;
- Të mos ushtrojnë veprimtari ekonomike.

Lidhur me këtë përfitim, nuk procedohet në vijim, pasi në Ligj është parashikuar një datë kufi e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit deri më 31 mars 2001.

Ligji 150/2014 datë 06.11.2014 "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë", si dhe VKM nr. 78, datë 28.01.2015 "Për zbatimin e Ligjit nr. 150/2014, datë 06.11.2014.

1. Personat përfitues:

Punonjësit, të cilët deri në datën 30.09.1993 kanë kryer procese pune në miniera, në nëntokë, sipas kriterëve të përcaktuara në kreun I, të Vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave "Për ndarjen e punës në kategori, për efekt pensioni", të ndryshuar dhe pas datës 30.09.1993 të kenë kryer procese pune në miniera, në nëntokë, të dokumentuara sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të ndryshuar, pavarësisht nëse të punësuarit kanë kryer aktivitet ekonomik në subjekte private apo me kapital plotësisht ose pjesërisht shtetëror.

Personat, që deri në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.150/2014, datë 06.11.2014, përfitonin trajtimin e veçantë financiar sipas Ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000 "Për një trajtim të veçantë financiar të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë", i ndryshuar.

2. Lloji i përfitimit:

Pension suplementar pleqërie.

3. Kushtet e përfitimit:

Kanë të drejtë të kërkojnë pension pleqërie si punonjës të minierave, në nëntokë, punonjësit, të cilët:

- a) arrijnë moshën 55 vjeç;
- b) kanë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, nga të cilat jo më pak se 12 vjet e 6 muaj në procese pune në miniera, në nëntokë, me përjashtim të ish-punonjësve të nëntokës që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas Ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000.

4. Cili është dokumentacioni që duhet të paraqitet për këtë përfitim dhe ku duhet të paraqitet ky dokumentacion?

Bashkëngjitur kërkesës dorëzohet dokumentacioni përkatës, sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pranë Agjencisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku është vendbanimi.

D. SKEMA E TRAJTIMIT TË VEÇANTË FINANCIAR TË PUNONJËSVE TË NDËRMARRJEVE TË INDUSTRIË USHTARAKE

1. Baza ligjore:

- Ligji nr. 9179, datë 29.01.2004 “Për një trajtim të veçantë financiar të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, i ndryshuar.

2. Ndryshimet:

- Ligji nr. 9687, datë 05.03.2007.

3. Personat përfitues:

- Sipas këtij Ligji përfitojnë punonjësit që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake.

4. Lloji i përfitimit:

- Trajtimi i veçantë financiar.

5. Kushtet e përfitimit:

- Në datën 31.12.2002 të kenë qenë në marrëdhënie pune në Kombinatin Mekanik në Poliçan, në Uzinën e Lëndëve Plasëse në Mjekës, në Uzinën Mekanike dhe Uzinën e Pilave në Gramsh dhe në Uzinën e Riparimit të Avioneve në Kuçovë, ose të jenë trajtuar në bazë të VKM-së nr. 389, datë 08.08.2002 dhe VKM-së nr. 695, datë 27.12.2002;
- Të kenë periudhë pune ose gatishmërie jo më pak se 15 vjet dhe periudhë sigurimi jo më pak se 18 vjet për gratë dhe periudhë pune ose gatishmërie jo më pak se 18 vjet dhe periudhë sigurimi jo më pak se 23 vjet për burra;
- Të kenë ndërprerë aktivitetin ekonomik.

Lidhur me këtë përfitim, nuk procedohet në vijim, pasi në Ligj është parashikuar një datë kufi e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit deri më 30.09.2004.

E. TRAJTIM I VEÇANTË FINANCIAR I PILOTËVE FLUTURUES NË PENSION

Cila është baza ligjore në mbështetje të të cilit, përfitoj përfitim suplementar si ish-pilot fluturues në pension?

1. Baza ligjore:

- Ligji nr. 9128, datë 29.07.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, i ndryshuar.

2. Ndryshimi:

- Ligji nr. 10135, datë 11.05.2009.
- Ligji nr.10353, datë 18.11.2010

3. Personat përfitues:

- Sipas këtij Ligji, përfitojnë pilotët ushtarakë që kanë fluturuar me avionë reaktivë dhe me helikë dhe bordi avion-drejtues i tyre;
- pilotët/technikët e Forcave të Armatosura, të cilët kanë fluturuar me helikopterë;
- pilotët/technikët e njësisë së transportit mjekësor me helikopter, të cilët kanë fluturuar me helikopterë;
- pilotët/technikët e repartit të helikopterëve të Policisë së Shtetit, të cilët kanë fluturuar me helikopterë;
- pilotët/technikët e Gardës së Republikës, të cilët kanë fluturuar me helikopterë.

4. Lloji i përfitimit:

- Pension suplementar pleqërie në shtesë të pensionit të pleqërisë.

5. Cilat janë kushtet që duhet të plotësoj për të përfituar?

Kushtet e përfitimit:

Pilotët që kanë fluturuar me avionë reaktivë e avionë me helikë, dhe helikopterë, të kenë plotësuar kushtet për pension pleqërie dhe të kenë fluturuar:

- Me avionë reaktivë jo më pak se 8,5 vjet kalendarikë;
- Me avionë me helikë jo më pak se 12,5 vjet kalendarikë;
- Jo më pak se 15 vjet vjetërsi në shërbim për funksionet aviondrejtues fluturues, qitës-radist, radist, teknik, fluturues bordi.

6. Cili është dokumentacioni që duhet të paraqitet për këto lloj përfitimesh dhe ku duhet të paraqitet ky dokumentacion?

Drejtohuni në strukturat rajonale të sigurimeve shoqërore, ku keni vendbanimin, dhe pajisuni me dy format- kërkesë.

- Një format-kërkesë e plotësuar paraqitet në strukturat, nga ku keni ndërprerë karrierën ushtarake dhe keni dalë në rezervë/lirim. Mbi bazë të kësaj kërkesë, këto struktura, dërgojnë në rrugë postare vërtetimin e viteve të shërbimit dhe të pagës referuese në strukturën rajonale të sigurimeve shoqërore, ku keni vendbanimin;

- Formati tjetër i kërkesës, plotësuar në të gjitha rubrikat, paraqitet pranë ALSSH-së, ku keni vendbanimin.

7. Dokumentacioni, bashkëngjitur kërkesës:

- Fotokopje e kartës identitetit.

F. TRAJTIMI I VEÇANTË FINANCIAR I EFEKTIVAVE OFICERË DHE NËNOFICERË LUNDRUES TË NËNDETËSEVE E POLUMBARËVE TË FORCAVE DETARE

Cila është baza ligjore në mbështetje të së cilës përfitoj përfitim suplementar, si ish-pilot fluturues në pension?

1. Baza ligjore:

- Ligji nr. 9361, datë 24.03.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave oficerë dhe nënoficerë lundruer të nëndetëseve dhe polumbarëve të forcave detare në pension”.

2. Personat përfitues:

- Sipas këtij Ligji përfitojnë efektivat oficerë dhe nënoficerë lundruer të nëndetëseve e të polumbarëve të forcave detare.

3. Lloji i përfitimit:

- Pension suplementar pleqërie në shtesë të pensionit të pleqërisë.

4. Cilat janë kushtet që duhet të plotësoj për të përfituar?

Kushtet për përfitim:

- Efektivat lundruer oficerë dhe nënoficerë lundruer të nëndetëseve e të polumbarëve të forcave detare, të kenë plotësuar kushtet për pension pleqërie dhe të kenë shërbyer jo më pak se 7 vite kalendarike.

5. Cili është dokumentacioni që duhet të paraqitet për këtë përfitim dhe ku duhet të paraqitet ky dokumentacion?

Paraqituni në strukturat rajonale të sigurimeve shoqërore, ku keni vendbanimin, dhe pajisuni me format- kërkesën.

- Mbi bazë të kësaj kërkesë, ISSH i kërkon Ministrisë së Mbrojtjes të dërgojë në rrugë postare vërtetimin e viteve të shërbimit dhe të pagës referuese në ISSH, nga ku përcillet në strukturat rajonale të sigurimeve shoqërore.

6. Dokumentacioni, bashkëngjitur kërkesës:

- Fotokopje e kartës identitetit.

G. SKEMA SUPLEMENTARE PËR PERSONAT QË GËZOJNË TITUJ SHKENCORË

1. Baza ligjore:

Ligji nr. 10139, datë 15.05.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të Universiteteve, Shkollave të Larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, që kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar.

2. Personat përfitues:

Sipas këtij Ligji, përfitojnë pensione suplementare shtetërore, si të ardhura shtesë mbi përfitimet që jepen sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, punonjësit e Universiteteve, Shkollave të Larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë.

3. Lloji i përfitimit:

Pension suplementar pleqërie.

4. Kushtet e përfitimit:

Personat që përfshihen në grupin e parë dhe të dytë të pikave 5 dhe 6 të nenit 2, të kenë plotësuar kriteret për marrjen e pensionit të pleqërisë, sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar.

Paraqituni në strukturat rajonale të sigurimeve shoqërore, ku keni vendbanimin dhe pajisuni me format- kërkesën.

5. Cili është dokumentacioni që duhet të paraqitet për këtë përfitim dhe ku duhet të paraqitet ky dokumentacion?

Dokumentacioni, bashkëngjitur kërkesës:

- Fotokopje e kartës identitetit;
- Deklaratë personale, nëse personi merr ose jo përfitime nga skema të tjera suplementare shtetërore;
- Fotokopje e noterizuar e dëshmisë për dhënien e titullit, ose në mungesë, një vërtetim për titullin shkencor, të lëshuar nga Komisioni i Kualifikimit ose nga Komisioni i Vlerësimit të Titujve;
- Vërtetim i pagës referuese;
- Vërtetim nga qendra e punës për kontributet suplementare të paguara nga data 01.01.2010 deri në datën e lindjes së të drejtës;
- Vërtetim për kohën e gëzimit të titullit.

H. SKEMA E DËSHMORËVE

1. Baza ligjore:

- Ligji nr. 8607, datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar.
Ndryshimet ligjore:
Ligji nr. 9650, datë 27.11.2006.

2. Lloji i përfitimit:

- Shpërblim mujor për familje.

3. Përfituesit:

- Ky shpërblim iu jepet familjarëve të Dëshmorit të Atdheut. Në rrethin e familjarëve bëjnë pjesë: bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët nën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, sipas certifikatës së gjendjes familjare në çastin e vdekjes së Dëshmorit të Atdheut.

4. Kushtet e përfitimit:

- Në rrethin e familjarëve bëjnë pjesë: bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët nën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, sipas çertifikatës së gjendjes familjare, në çastin e vdekjes së Dëshmorit të Atdheut.

5. Dokumentacioni, bashkëngjitur kërkesës:

- Certifikatë familjare në çastin e vdekjes së dëshmorit;
- Certifikatë e vdekjes së dëshmorit;
- Fotokopje e kartës identitetit së përfituesit;
- Certifikatë familjare e familjarit që ushtron të drejtën;
- Vërtetim për vazhdimin e shkollës për jetimët.